



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1154/ 10_prot.

Datë 11.05.2026

V E N D I M
Nr.621/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.05.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 561/2026, datë 28.04.2026 për procedurën e prokurimit, “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-81198-04-07-2026, me objekt: “Blerje materiale për pastrim ambientit”, me fond limit: 3,224,810.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me 20-04-2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Mirembajtjes së Objekteve Publike, Shkodër.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Besim Kamberi” PF me NIPT 42103023G dhe adresë Tiranë, Rruga e Qelqit, Zona Kadastrale Nr. 3866, Nr. Pasurie 310/20 - Kashar 1001.
- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Përgjithshme e Mirembajtjes së Objekteve Publike, Shkodër dhe adresë: *Lagjia Tre Heronjte, Rruga Marin Bicikemi-Shkoder*
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 28.04.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 561/2026, ku vendosi:

- 1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Besim Kamberi” pf për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-81198-04-07-2026, me objekt: “Blerje materiale për pastrim ambienti”, me fond limit: 3,224,810.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me 20-04-2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike, Shkodër.*
 - 2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.*
 - 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit.*
 - 4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse, për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Besim Kamberi” pf.*
 - 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
 - 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën nr. 362 prot., datë 30.04.2026, protokolluar me tonën nr. 1154/7 prot., date 06.05.2026, autoriteti kontraktor, Drejtoria e Pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike, Shkodër, njofton se ka bërë modifikimin e dokumentave të tenderit si dhe gjithashtu në vijim autoriteti kontraktor kërkon heqjen e pezullimit për procedurë objekt ankimi.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr. 362 prot., datë 30.04.2026, protokolluar me tonën nr. 1154/7 prot., date 06.05.2026, autoriteti kontraktor, Drejtoria e Pergjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike, Shkodër, njofton se ka bërë modifikimin e dokumentave të tenderit si dhe gjithashtu në vijim autoriteti kontraktor kërkon heqjen e pezullimit për procedurë objekt ankimi.

II.2. Nga verifikimi i shtojcës së publikuar në sistemin elektronik si dhe referuar shkresës nr. 362 prot., datë 30.04.2026, protokolluar me tonën nr. 1154/7 prot., date 06.05.2026, autoriteti kontraktor, rezulton se ka zbatuar vendimin nr. 561/2026, datë 28.04.2026.

II.3. Për sa më sipër, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike, Shkodër, ka zbatuar vendimin Nr. 561/2026, datë 28.04.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit me nr. REF-81198-04-07-2026, me objekt: “Blerje materiale për pastrim ambienti”, me fond limit: 3,224,810.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me 20-04-2026 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Mirembajtjes se Objekteve Publike, Shkodër.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

